



Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) ndërsa në pajtim me nenin 40 paragrafi 3 dhe neni 41 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të marë nga parashtrues i panjohur në seancën e77-të, të mbajtur më 14.11.2022, morri vendimin vijues:

#### VENDIM

Veprimi ndaj lëndës me numër 12-3764/1 datë 02.11.2021, NDËRPRITET

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave ,KSHPK vlerësoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në lëndën.

Lënda me numër arkivor 12-3764 e vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim- në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të saj në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

#### Arsyetim

Lënda me numër 12-3764/1 i datës 02.11.2021 në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK) e formuar në bazë të një denoncimi të marrë nga një parashtrues i panjohur (në tekstin e mëtejme: parashtruesi).

Denoncimi përmban pretendime për sjellje jokonsekionale dhe shpërdorim të pozitës dhe autorizimeve zyrtare nga personi zyrtar ///, i cili, si ushtruese e /// // në ///, vazhdoi të merrte pagë si drejtoreshë edhe pse mandati i saj skadoi në vitin///. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Prova ndaj denoncimit nuk u dorëzuan.

Me qëllim të ushtrimit të kompetencave të veta ligjore, për këtë rastin konkret, KSHPK-ja ka kërkuar të dhëna, informacione, dokumentacion dhe veprime kompetente nga ///, ku gjithçka që është kërkuar është vepruar dhe dorëzuar në mënyrë konsekuente.

KSHPK-ja, pasi vlerësoi se ka fakte dhe prova të mjaftueshme, ka vazhduar me konstatimin e situatës në këtë rast konkret, dhe pasi ka vlerësuar çdo provë si dhe të gjitha provat në tërësi dhe analizën e vetme dhe tërthore të të gjitha fakteve të njohura u konstatua se në këtë rast pretendimet janë krejtësisht të pabaza. Konkretisht, edhe pse mandati i personit të përmendur në denoncim kaloi më ///, në rastin konkret nuk ekziston akt për shkarkimin e personit zyrtarë nga pozita drejtor në shkollën e përmendur, nga ku del se pagesa e pagës është bërë në përputhje me ligjin.

Nga sa u tha më lartë, KSHPK-ja konstatoi se lënda nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm, pas së cilës vlerësoi se veprimi sipas denoncimit duhet të ndërpritet dhe të vendoset si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:

- Arkivi i KSHPK-së

KOMISIONI SHITETËRORË  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
Kryetare,  
Biljana Ivanovska

Përgaditi: Mr D. D.  
Miratoi: G.T.